

**SHBALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
NGRITJE NË DETYRË  
PRANIMI NGA JASHTË**

**NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

(Përgjegjës në Sektorin e Financës)

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Dibër shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për pozicionin:

**Përgjegjës në Sektorin e Financës në Këshillin e Qarkut Dibër**

**Kategoria III a/1**

Lloji i diplomës: **Niveli minimal i diplomës “Master” në shkencat Ekonomike.**

**Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!**

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë ose pranim nga jashtë .

**Për të tre procedurat lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!**

|   |                        |
|---|------------------------|
| <b>Afati për dorëzimin e dokumentave për<br/>LËVIZJE PARALELE:</b>  | <b>02. Korrik 2022</b> |
| <b>Afati për dorëzimin e dokumentave për<br/>NGRITJE NË DETYRË:</b> | <b>07 Korrik 2022</b>  |
| <b>Afati për dorëzimin e dokumentave për<br/>PRANIM NGA JASHTË:</b> | <b>07 Korrik 2022</b>  |

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

- a) Përfaqëson Sektorin në të gjitha marrëdhëniet e saj me Sektorët në Këshillin e Qarkut

Dibër, institucionet e ndryshme si dhe me të gjitha organet shtetërore, vendore për problemet që ka sektori në kompetencë.

- b) Përgjegjësi në Sektorin e Financës, (Nëpunësi Zbatues ) siguron që burimet në dispozicion të këtij sektori të mirëorganizohen në mënyrë që objektivat e përcaktuara në këtë Sektor të organizohen në afatet kohore të parashikuara, me sa më pak kosto, duke siguruar efektivitet të lartë, në mënyrë të tërësisë të rregullt dhe korrekte.
- c) Raporton për gjendjen financiare të institucionit.
- d) Bën të mundur ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të duhura në hartimin e politikave rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikat qendrore për zhvillimin ekonomik-social në nivel Qarku e më gjërë.
- e) Bën të mundur ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të duhura në hartimin e projekt-buxhetit vjetor .
- f) Bën të mundur ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të duhura në hartimin e projekt-buxhetit afat – mesëm.
- g) Organizon, mbikëqyrë dhe kontrollon zbatimin e buxhetit duke u bazuar në legjislacionin për financat.
- h) Përcakton burimin e të ardhurave, normat dhe kriteret e administrimit të këtyre të ardhurave.
- i) Përgatit dokumentacionin për realizimin e buxhetit çdo 4/ muaj dhe vjetor.
- j) Organizon dhe drejton funksionimin e kontabilitetit .
- k) Përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale (inventarit ekonomik) dhe monetarë.
- l) Harton dhe përpilon listëpagesat, pagat dhe sigurimet e punonjësve, dhe hedhjen në sistem.
- m) Përgatit projekt vendimet për në Këshillin e Qarkut.
- n) Punon për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve me financim të huaj.
- o) Përpilon urdhër shpenzimet për likuidimet e projekteve me financim të huaj sipas ligjit në fuqi.
- p) Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ligji.

## **LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III- a/1
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- a – Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master Shkencor/ Profesional” në shkencat Ekonomike. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë të paktën 2 (dy) vite përvojë pune në nivel të ulët drejtues dhe jo më pak se 5 vite punë në profesion.

c-Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

d-Të zotëroj shumë mirë gjuhën angleze.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës e noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 02.07.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Dibër, Zyra e Burimeve Njerëzore, godina e prefekturës Kati i III- të ,Dibër.***

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **04.07.2022**, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Dibër **listën e kandidatëve** që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Këshillit i Qarkut Dibër, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

- Ligjin Nr.\_\_\_\_ “Për Buxhetin e vitit 2022”.
- Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi rregullat e PRAG.
- Ligjin Nr.10399, datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

1. a) **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
2. b) **60 pikë** intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Dibër.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për

shpalljen e fituesit.

## 2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë Informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Dibër.

### 2.1

## KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më ulët), të punësuar në të njëjtin apo në institucione të tjera të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë të cilët plotësojnë kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (nëpunësi civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III B.
- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master Shkencor/Profesional” në shkencat Ekonomike, edhe Diploma e nivelit “Baçelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni).
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.
- Të kenë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të zotëroj shumë mirë gjuhën angleze.

### 2.2

## DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b-Fotokopje e noterizuar të diplomës përfshirë edhe diplomën bachelor.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

h-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

i-Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Këshillin e Qarkut Dibër.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07.07.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Dibër, Zyra e Burimeve Njerëzore, godina e prefekturës Kati i III- të ,Dibër.**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **17.07.2022**, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut dibër, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”.
- Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi rregullat e PRAG.
- Ligjin Nr.10399, datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

## **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- deri në **20 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar
- b- deri në **40 pikë** për vlerësimin me shkrim
- c- deri në **40 pikë** për Intervistën e strukturuar me gojë

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Dibër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **3 PRANIMI NGA JASHTË**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.  
Këtë Informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Dibër.

Në këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë dhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **3.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBYMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

### **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

#### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
  - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
  - d- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
  - e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen zyrtare elektronike të Departamentit të Administratës Publike, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijimësi udhëzimet online.

<http://rekrutimi.administrata.al/autentifikimi/regjistrim>

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Këshillin e Qarkut Dibër.

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07.07.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Dibër, Zyra e Burimeve Njerëzore, godina e prefekturës Kati i III- të ,Dibër.***

### **3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **17.07.2022**, Këshilli i Qarkut Dibër do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut Dibër, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

---



### **Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”.
- Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi rregullat e PRAG.
- Ligjin Nr.10399, datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- d- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- e- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- f- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- d- deri në **20 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar
- e- deri në **40 pikë** për vlerësimin me shkrim
- f- deri në **40 pikë** për Intervistën e strukturuar me gojë

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Dibër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Dibër për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Dibër duke filluar nga data **17.07.2022**.

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
**Valentina Haliti**